



VENDIM
Nr. 999, datë 9.12.2020

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
“STANDARDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR
NË SHQIPËRI – TEMA: NJËSITË
STATISTIKORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “k”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Njësitet statistikore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse përmbladhjen, përpunimin e përditësimin e të dhënave gjeohapësinore përditësimi dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRËR
Erion Braçë

**STANDARDET SHTETËRORE
PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË
SHQIPËRI – TEMA: NJËSITË
STATISTIKORE”**

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

2.2 Si lexohet dokumenti

2.3 Detyrimet ligjore

2.4 Fusha e veprimit

- 3. TEMA
- 3.1 Njësitet statistikore
 - 3.1.1 Parathënie
 - 3.1.2 Skema e aplikimit dhe diagrami UML për temën “Njësitet statistikore”
 - 3.1.2.1 Njësitet statistikore – Formati bazë
 - 3.1.2.2 Njësitet statistikore – Formati rrjet
 - 3.1.2.3 Njësitet statistikore – Formati vektor
 - 3.1.3 Katalogu i tipologjisë
 - 3.1.3.1 Njësitet statistikore
 - 3.1.3.2 Rrjeti statistikor
 - 3.1.3.3 Njësitet statistikore vektor
 - 3.1.3.4 Evolucion
 - 3.1.3.5 Elementet statistikore të rrjetit
 - 3.1.3.6 Gjeometria e njësisë statistikore vektor
 - 3.1.3.7 Gjeometria përshkruese
 - 3.1.3.8 Mozaiku statistikor
 - 3.1.3.9 Njësitet statistikore poligon/sipërfaqe
 - 3.1.3.10 Pozicioni i rrjetit
 - 3.1.3.11 Rezolucioni i rrjetit statistikor
 - 3.1.3.12 Vlerat e llojeve të gjeometrisë
 - 3.1.3.13 Vlerat e llojit të evolucionit
 - 3.2 Metadata
 - 3.3 Kodi EPSG për KRGJSH-në
 - 3.4 Cilësia e të dhënave
 - 3.4.1 Kompletimi – Autorizimi (*Completeness - Commission*)
 - 3.4.2 Kompletimi – Përjashtimi (*Completeness - Omission*)
 - 3.4.3 Përputhja logjike – Përputhja topologjike (*Logical consistency – Topological consistency*)
 - 3.4.4 Saktësia pozicionale – Saktësia absolute ose e jashtme (*Positional accuracy – Absolute or extrenal accuracy*)
 - 3.4.5 Saktësia tematike – Korrekësia e klasifikimit (*Thematic accuracy – Classification correctness*)
 - 3.4.6 Cilësia e kohës – Vlefshmëria e kohës (*Temporal quality – Temporal validity*)
 - 4. ANEKSE
 - 4.1. Aneksi A - Katalogu i tipologjisë
 - 4.2. Aneksi B - Kodlistat
 - 4.2.1 Skema e aplikimit të temës “Njësitet statistikore”
 - 4.2.2 Vlerat e llojeve të evolucionit
 - 4.2.3 Vlerat e llojeve të gjeometrisë
- 1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standarde të specifikuara teknike të të dhënave gjeohapësinore përditësimi i NSDI-së, duke u mbështetur në



direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), i cili është autoriteti publik përgjegjës për temën “Njësitë statistikore”.

Data e publikimit të versionit nr. 1 është tetor 2018. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2018_NJS_v.1, ku:

ASIG– autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit;

Standard – lloji i dokumentit;

NSDI– qëllimi i dokumentit;

2018 – viti i krijimit;

NJS – tema për të cilën është krijuar standardi “Njësitë statistikore”, e cila i referohet temës “Statistical Units” në Direktivën INSPIRE;

v.1 – Numri i versionit të standardit.

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, të harmonizuara konform direktivës INSPIRE, për të dhënat gjeohapësinore të temës “Njësitë statistikore”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/k, të ligjt nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI-së¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unik dhe korrekte e të dhënavë dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë mes tyre.

2.2 Si lexohet dokumenti

2.2.1 Struktura e dokumentit

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autorë i standardeve.

2. Hyrje – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i

gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3. Tema – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Njësitë statistikore”.

4. Anekse – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

Përbajtja e kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:

3.1 Përshkrimi i temës – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përbajtjen e temës si dhe se si është e ndarë kjo temë.

3.2 Metadata – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.3 Sistemi Koordinativ Referencë – Këtu përcaktohet Sistemi Koordinativ Referencë (KRGJSH).

3.4 Cilësia e të dhënavë – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënavë të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJISË

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në “Katalogun i tipologjive” (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përbajtjen e modelit të të dhënavë, duke u fokusuar te katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, katalogu i tipologjive, mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënavë, në katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kodlistës.

¹ NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.



Tabela 1

| Emri - Emërtimi i tipologjisë | |
|-------------------------------|---|
| Përkufizimi | Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë. |
| Përshkrimi | Shënime dhe përshkrome të tjera për tipologjinë. |
| Lloji i tipologjisë | <p>Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> “feature Type” – një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte; “data Type” – një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë atribute, për t'u lidhur me një element tjeter; “enumeration” “kodlistë” – listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa “<i>codeList</i>” nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numëritimet dhe kodlistat”; “union” – një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet që bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dyja grupeve të të dhënave hyrëse; “Imported” – të dhëna të specifikuara në tema të tjera të DIREKTIVËS INSPIRE. Në dokument gjinden “Të dhënat e importuara”. |
| Gjeometria | <p>Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon.</p> <p>Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.</p> |
| Shumëllojshmëria | <p>Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi:</p> <ul style="list-style-type: none"> 0.* – mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnje vlerë; 1..* – mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera; 0..1 – mund të mos marrë asnje vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme; 1 – duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë. |
| I detyrueshëm | <p>Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet;</p> <p>Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet.</p> |
| Rolshoqërimi | Në tabelën e lidhjeve “Rolshoqërimet” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML. |

Tabela 2

| ATRIBUTET |
|--|
| -- Emri -- |
| Emërtimi i atributit |
| -- Përkufizimi -- |
| Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve. |
| -- Përshkrimi -- |
| Shënime dhe përshkrome të tjera për elementin |
| [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh.: PO]. |

Tabela 3

| ATRIBUTET |
|--|
| 💡 Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh.: Ligjor |
| -- Emri -- |
| Emërtimi i vlerës |
| -- Përkufizimi -- |
| Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve. |



ATRIBUTET

💡 Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh.: ***Joligjor***

-- Emri --

Emërtimi i vlerës

-- Përkufizimi --

Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve.

2.2.3 Karakteristikat e “voidable” dhe shumëllojshmëria

Stereotipi “voidable” përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore, që mund të janë ose mund të mos janë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera “void”. Një vlerë “void” nënkuption që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës “void” duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArysesSëPavleshmërisë* (*VoidReasonValue*), e cila përmban:

***E panjohur* (Unknown)**

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” e një ligjeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyja e pavleshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “e panjohur”.

***E papopulluar* (Unpopulated)**

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të ligjenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “e pa populluar”.

***Konfidenciale* (Withheld)**

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi “voidable” nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh., nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh., nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit *Coverages* përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitet, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh., vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh., izolinjat), rrjetet (p.sh., ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të Inspire, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si vetitë e llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është një realizim i një prej llojeve të specifikuara në SSH EN ISO 19123:2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standartet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh., ISO 19136



dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptues të Përgjithshëm.

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

Rjeti i Mbulimit i Korrigjuar (rekëfikuar): Mbulimi, domeini i të cilët përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe

koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, majtas).

Rjeti i Mbulimit Reference: Mbulimi, domeini i të cilët përbëhet nga një rrjet referimi - një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje të mbulimit (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në Inspire.




Figura 1: Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5 Numërtimet dhe kodlistat (*Enumeration and Kodliste*)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistë, "vlera të tjera" përcaktojnë llojin e përbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

"jo" përfaqëson kodlista që përbajnjë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument;

"të kufizuara" përfaqëson kodlista që përbajnjë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënavë;

"të hapura" përfaqëson kodlista që përbajnjë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënavë;

"po" përfaqëson kodlista që përbajnjë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënavë.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënavë nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënavë do të përdorin kodlista me vlera **"jo"**, pra të specifikuara në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë

këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistr. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 Paraqitura e dimensionit kohor

Skemat e aplikimit përdorin atributin **"Fillimi i Ciklit Jetësor"** dhe **"Përfundimi i Ciklit Jetësor"** për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi **"Fillimi i Ciklit Jetësor"** specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënavë gjeohapësinore (në sistem). Atributi **"Përfundimi i Ciklit Jetësor"** specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënavë gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin **"Përfundimi i Ciklit Jetësor"** nuk shkaktojnë ndryshime në atributin **"Fillimi i Ciklit Jetësor"**.

Shënim i rëndësishëm

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh., Feature Type, Data Type, Void, Coverages etj., nuk janë përkthyer qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të direktivës Inspire.



2.3 Detyrimet ligjore

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG-u është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva Inspire).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specififikimet teknike të temave përkatëse në direktivën Inspire, si dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen përfundimisht e mëposhtme:

- Metadata** – Në këtë fushë, direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm përfundimisht.

gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë (VKM nr. 1077, datë 23.12.2015).

- Specifikimi i të dhënave** – Standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. Inspire ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë përfundimisht publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera përfundimisht.

2.4 Fusha e veprimit

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individët që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore përfundimisht llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtronin këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva Inspire ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:




Figura 2: Proseset e ciklit jetësor



“Planifikimi” është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

“Vlerësimi” është procesi gjatë të cilit të dhënata ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënata që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

“Procesimi (përpunimi)” është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhëna gati për t'u publikuar.

“Shpërndarja” është procesi gjatë të cilit të dhënata vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, institucionet ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënata. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

“Zbulimi” është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënata e publikuara.

“Analiza” është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënata që janë evidentuar.

“Përditësimi” është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

“Arkivimi” është procesi gjatë të cilit bashkësítë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesoher, arkivoher duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënata që bëhen të paaksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsyet e përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standartet specifike.

“Shkatërrimi” është procesi gjatë të cilit të dhënata bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 Njësitë statistikore

3.1.1 Parathënie

Njësitë statistikore janë përcaktuar si “njësi për shpërndarjen ose përdorimin e informacionit statistikor”.

Një *Njësi Statistikore (NS)* është një tipar gjeohapësinor (*poligon, vijë, pikë ose rrjet qelizash*), që mund të përdoret për të bashkëngjitur informacionin statistikor. Informacioni statistikor mund të përkufizohet si “çdo përfaqësim numerik i një fenomeni”, si për shembull, popullsia (referencia është për popullsinë njerëzore). Ky informacion, duhet të japë informacionin për një popullsi të caktuar dhe jo të kufizohet në popullatën njerëzore.

Informacioni statistikor nuk konsiderohet si pjesë e njësisë statistikore. Është një informacion johapësinor tematik, harmonizimi i të cilit është jashtë qëllimit të këtij dokumenti. Për këtë informacion i referohemi specifikimit të temës “*Demografia/Shpërndarja e Popullsisë*”. Ky dokument përqendrohet vetëm në përfaqësimin e tipologjive gjeohapësinore që përdoren për të bashkëngjitur çdo lloj informacioni statistikor.

Të gjitha tipologjite e temave të Inspire mund të shihen si njësi statistikore. Për shembull, të dhënat e trafikut rrugor mund të lidhen me tipologjinë *Lidhje Rrugore* e temës “*Rrjetet e Transportit*”. Të dhënat e popullsisë mund të lidhen me tipologjinë e *ndërtesave* të temës “*Ndërtesat*”.

Tema “*Njësitë statistikore*” trajton njësitë që nuk janë adresuar nga tema të tjera dhe që zakonisht përdoren vetëm për shpërndarjen e të dhënave statistikore.

Ky dokument paraqet specifikimet e të dhënave për njësitë statistikore, duke u mbështetur në parimet e mëposhtme:

- **Ndarja ndërmjet të dhënave statistikore dhe njësive statistikore**

Të dhënat statistikore përkufizohen si “çdo përfaqësim numerik i një fenomeni”. Një njësi statistikore jep informacion për vendndodhjen e të dhënave statistikore. Informacioni statistikor nuk cilësohet si pjesë e njësisë statistikore. Ky dokument trajton vetëm specifikimet e të dhënave për njësitë statistikore (ndërsa specifikimi i të dhënave statistikore është jashtë qëllimit). Parimi është të sigurohet një paraqitje e qëndrueshme dhe e identifikuveshme e njësive statistikore (të dhënat statistikore u referohen këtyre objekteve nëpërmjet



identifikuesit të tyre). Në këtë dokument janë dhënë disa rekomandime për mënyrën e paraqitjes së identifikuesit të qëndrueshëm të njësive statistikore dhe si të përdoren këto identifikues për të bashkëngjitur informacionin statistikor mbi to. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse përgjegjësia për gjeometrinë dhe të dhënat statistikore ndahet midis institucioneve të ndryshme, p.sh., agjencitë e hartave dhe zyrat statistikore.

Lidhja e të dhënave statistikore me objektin gjeohapësinor nuk është vetëm lidhja e një objekti të një baze të dhënash me një tjetër, por objektivi është përmirësimi i ndërveprimit midis statistikave dhe sistemit të informacionit gjeografik (GIS). Rekomandimet e këtij dokumenti synojnë përmirësimin e integrimit të analizave gjeohapësinore dhe statistikore.

- Përgjithësim

Modeli i të dhënave nuk ka për qëllim të harmonizojë të gjithë njësitet statistikore ekzistuese si për shembull: zonat e censusit, zonat e menaxhimit, njësitat mjedisore etj. Ky dokument ka për qëllim të ofrojë një model abstrakt të njësive statistikore. Këtu janë nxjerrë karakteristikat e përbashkëta dhe që përfaqësohen në një model të përgjithshëm të të dhënave.

- Njësítë statistikore si gjeometri vektoriale dhe qelizat e rrjetit

Njësítë statistikore zakonisht përfaqësohen si:

Gjeometri vektoriale (pikat, vijat, sipërfaqet), kryesisht sipërfaqet. Njësítë statistikore, kryesisht sipërfaqet përbënë një mozaik (një mozaik është një bashkim i sipërfaqeve që mbulojnë një pjesë të hapësirës gjeografike pa mbivendosje dhe pa boshllqe).

Qelizat e rrjetit

Ky dokument ofron rekomandime për përfaqësimin e llojeve të mësipërme të njësive statistikore.

- Marrëdhëniet hierarkike ndërmjet njësive statistikore

Disa njësi statistikore janë organizuar në një strukturë hierarkike: disa njësi statistikore formojnë njësë të tjera të një nivelit më të lartë. Për këtë arsyen janë paraqitur rekomandime për të përfaqësuar struktura të tillë.

- Përfaqësim në shkallë të gjërë

Njësítë statistikore kanë disa përfaqësimë në shkallë të ndryshme. Për shpërndarjen e të dhënave

Faqe | 16806

statistikore në shkallë evropiane, kërkohen përfaqësimë të thjeshta të njësive statistikore. Për të përmbrushur këtë kërkesë, ky dokument përcakton se si mund të specifikohen përfaqësimë të ndryshme të njësive statistikore.

- Evoluimi i njësive statistikore

Ekzistonjë kërkesa specifike në lidhje me evoluimin e njësive statistikore në kohë. Disa njësi mund të ndryshohen, fshihen, krijohen, bashkohen ose ndahen. Shumë raste të përdorimit të njësive statistikore kanë të bëjnë me evoluimin e të dhënave statistikore në kohë dhe hapësirë. Ky dokument specifikon se si mund të përfaqësohen faza të ndryshme dhe ecuria e njësive statistikore.

Disa nga karakteristikat e rëndësishme të njësive statistikore janë:

- Ato mund të kenë një strukturë hierarkike (p.sh., NUTS1, NUTS2 dhe NUTS3).

- Shtrirja e tyre gjeohapësinore mund të shkojë nga niveli më i ulët administrativ (më i vogël se bashkitë/komunitetet) deri në nivel kombëtar vendi.

- Shtrirja e tyre kohore ndryshon sipas vendit. Ata mund të ndryshojnë në kohë, gjë që e bën të vështirë krahasimin në kohë.

- Në shumë raste ato rrjedhin nga njësitat administrative, por burime të tjera janë, gjithashtu, të mundshme.

Njësítë statistikore ekzistuese

NUTS² - Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika

Që prej shumë vitesh statistikat rajonale evropiane janë mbledhur, përpunuar dhe shpërndarë në bazë të një klasifikimi të përbashkët rajonal, të quajtur *Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat* (NUTS). Në krye të hierarkisë qëndrojnë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe nën nivelet NUTS 1 deri 3. Në përgjithësi, një ose dy nivele NUTS përputhen me njësitat administrative kombëtare ekzistuese të vendeve të ndryshme. Për këtë arsyen, njësítë NUTS janë një lloj i rëndësishëm i njësive statistikore. Për këtë sistem klasifikimi janë përcaktuar rregulla të qarta në kuadrin ligjor (Rregullorja (KE) nr. 1059/2003).

LAU³ Njësítë Administrative Lokale dhe Urban Audit (qytete me dendësi të lartë)

² NUTS - Nomenclature of Territorial Units for Statistics.

³ LAU - Local Administrative Units.



Klasifikimi i NUTS-ve shërben si një sistem i harmonizuar për aplikime në nivel evropian dhe rajonal, ndërkohë që nuk përashton ekzistencën e nënndarjeve dhe klasifikimeve të tjera. Në një nivel më të detajuar, ekzistonjë bashkitë e përdorura në kontekstin evropian. Këto quhen *Njësitë Administrative Lokale (LAU)* të përdorura në legjislacionin evropian. Shembuj të tjerë të njësive statistikore janë zona urbane të përdorura në projektin e qyteteve me dendësi të lartë (Urban Audit), organizuar nga Eurostat. As Njësitë Administrative Lokale (LAU) dhe as Urban Audit (UA) nuk janë subjekt i NUTS apo i ndonjë rregulloreje tjetër evropiane.

- Njësi statistikore lokale të tjera

Breda shumicës së bashkive ekzistojnë dhe nënndarje të tjera territoriale, që përdoren për administrimin bashkiak, vrojtimet statistikore (p.sh. zonat e Censusit etj.) dhe qëllime të tjera specifike tematike dhe për të cilat jepen të dhënat statistikore. Të gjitha këto njësi nuk janë të harmonizuara në Evropë dhe nuk janë përshtatur në nivel evropian.

- Njësi statistikore specifike sektoriale

Njësitë statistikore përdoren gjithashtu për qëllime specifike sektoriale (si për shembull ronen e sigurisë civile, zonat e jurisprudencës ose ronen turistike). Njësi të tillë statistikore sektoriale konsiderohen jashtë qëllimit, pasi harmonizimi i të gjitha këtyre njësive statistikore specifike në nivel evropian mund të jetë një përpjekje që nuk ia vlen. Meqë modeli i të dhënavës eshtë i përgjithshëm, eshtë e mundur që të përdoret edhe për qëllime specifike sektoriale, por nuk ka asnjë detyrim për të siguruar njësi të tillë statistikore sipas këtij specifikimi të të dhënavës.

- Rrjeti

Ndarja e njësive statistikore bazohet në ndarjet administrative ose tematike, por gjithashtu përdoren edhe ndarjet territoriale abstrakte, të cilat shërbejnë si referencë gjeohapësinore për statistikat dhe quhen *rrjete*. Rrjetet janë kuadrate me madhësi të ndryshme të orientuara në sistemin koordinativ KRGJSH, të pavarur nga kufijtë administrativë ose tematikë.

- Përdorimet e njësive statistikore

Njësitë statistikore janë të nevojshme në kuadër të qeverisjes vendore, qeverisjes qendrore, vendbanimeve, zhvillimit urban dhe rajonal, planifikimit shëndetësor dhe arsimor, planifikimit

të regjistrimit në shkolla, vlerësimit të rreziqeve etj. Ato janë me rëndësi të madhe për analiza të integruara për zona dhe rajone. Gjithashtu, janë të nevojshme si karakteristika gjeografike edhe në vlerësimet mjedisore dhe sociale. Njësitë statistikore mund të përdoren si bazë gjeografike për hulumtime në pothuajse çdo fenomen.

Njësitë statistikore mund të përdoren për mbledhjen e të dhënavës, si dhe për aggregimin ose paraqitjen e të dhënavës (në shkallë të ndryshme, për qëllime të ndryshme, për shembull: në nivele të ndryshme statistikore NUTS). Në mënyrë të ngashme si njësitë administrative, njësitë statistikore mund të përdoren për të gjoreferuar të dhënat nga fusha të ndryshme statistikore, si demografia dhe statistikat sociale, ekonomia, mjedisit dhe burimet natyrore. Njësitë statistikore përdoren, gjithashtu, për analizën e riskut (p.sh., rreziku i përmbytjes), kryesisht në lidhje me shpërndarjen e popullsisë.

- Lidhja me temat e tjera

Grupet e të dhënavës të adresuara në këtë temë mund të mbulohen, gjithashtu, dhe në tema të tjera të INSPIRE ose si gjemometri/objekte të mbivendosura, ose si një gjemometri e nevojshme për prezantime tematike. Njësitë statistikore mund të përdoren si bazë për bashkimin, grumbullimin dhe paraqitjen e hartave për pothuajse çdo temë ose çështje të sektorit. Tema "Njësitë statistikore" ka lidhje me temat "Kufijtë e njësive administrative", "Demografia", "Zonat me përdorim të kufizuar", "Sistemet e rrjeteve gjeografike" dhe "Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij".

Skema e aplikimit dhe diagrami UML për temën "Njësitë statistikore"

Një njësi statistikore eshtë shprehur si një njësi e përdorur për shpërndarjen ose mbështetjen e përdorimit të informacionit statistikor. Sipas këtij përkufizimi, të gjitha objektet gjehapësinore të temave të gjeoinformacionit mund të konsiderohen si njësi statistikore. Kjo skemë aplikimi ofron objekte që nuk janë mbuluar nga tema të tjera dhe që përdoren zakonisht për referencën gjehapësinore të të dhënavës statistikore.

Karakteristikat kryesore të modelit të të dhënavës të njësise statistikore nga Inspire janë si më poshtë:

Të përgjithshme

Modeli i të dhënavës nuk ka për qëllim të harmonizojë të gjitha njësitë statistikore specifike ekzistuese, si zonat e Censusit, zonat e menaxhimit,



njësitë raportuese mjedisore etj. Filozofia është të sigurojë një model abstrakt të njësive statistikore që më tej mund të specializohen për njësi të veçanta statistikore (nëse nevojiten). Kjo ka të bëjë me legjislacionin specifik të temave për të përshkruar nevojat e specializimit të këtij modeli.

Rrjeti, gjeometria dhe mozaiku

Njësitë statistikore mund të përfaqësohen si rrjet qelizash dhe gjeometri vektoriale (pikë, linjë (vijë) dhe poligon). Një numër i konsiderueshëm i njësive statistikore ekzistuese janë njësitë statistikore poligone (sipërfqaqe), që formojnë një mozaik. Për aplikimet panevropiane, përshkruhet një rrjet i rekomanduar panevropian.

Përfaqësim në shkallë të gjërë

Njësitë statistikore vektor mund të përfaqësohen nga gjeometri të ndryshme në shkallë të ndryshme.

Struktura hierarkike

Strukturat hierarkike të njësive statistikore mund të përfaqësohen në disa nivele. Lëvizja ndërmjet njësive statistikore të niveleve të njëpasnjëshme është e mundur.

Dimensioni kohor

Evolimi në kohë i njësive statistikore vektoriale mund të përfaqësohet. Është e mundur gjithashtu të gjurmojmë se si këto njësi kanë ndryshuar në kohë. Evoluimi i njësive statistikore nënkupton dhe

mundëson krijimin, fshirjen, modifikimin, bashkimin dhe ndarjen e tyre. Këto ndryshime mund të përfaqësohen në mënyrë të qartë. Kjo përshkruhet më tej në pjesën e përfaqësimit të dimensionit kohor.

Përbledhja e UML-së

Skema e aplikimit mbi njësitë statistikore përbëhet nga paketa të ndryshme:

Baza: Paketa bazë.

Rrjet: Klasat për të përfaqësuar rrjetet statistikore.

Vektor: Klasat për të përfaqësuar njësitë statistikore që kanë gjeometri vektoriale (pikë, vijë, poligon/sipërfqaqe).

Këto paketa importojnë paketat e mëposhtme:

Paketa e tipave bazë e përcaktuar në modelin konceptual.

Gjeometria: Standardi ISO për të përfaqësuar gjeometritë (SSH EN ISO 19107:2005).

Këto paketa përshkruhen në seksionet e mëposhtme.

Njësitë statistikore - Formati bazë

Kjo paketë përmban klasifikimin abstrakt të kategorisë së *Njësive Statistikore* (shih figurën 3). Një njësi statistikore përcaktohet si një element gjeohapësinor i përdorur për shpërndarjen ose përdorimin e informacionit statistikor.




Figura 3: Diagrami e klasifikimit të paketës UML bazë

Njësitë statistikore mund të karakterizohen nga disa të dhëna statistikore. Modeli i të dhënave ofron dy specializime të klasës së *Njësi Statistikore*: Rrjeti i qelizave, të përshkruara në paketën *Rrjetet* dhe *Njësitë Statistikore Vektoriale*, të përshkruara në paketën *Vektor*.

3.1.2.2 Njësitë statistikore - Formati rrjet

Kjo paketë (shih figurën 4) përmban klasa për të përfaqësuar rrjetet statistikore (klasa *Rrjetet Statistikore*) të përbërë nga rrjeti i qelizave (klasa *Qeliza e Rrjetit Statistikor*).




Figura 4: Diagrami UML e paketës së Rrjetit

Një rrjet statistikor identifikohet nga një identifikues Inspire dhe karakterizohet nga një sistem referues koordinativ (përfaqësuar nga kodi i tij EPSG). Ajo karakterizohet, gjithashtu, nga një rezolucion, i cili mund të jetë një gjatësi, (nëse sistemi i referimit të koordinatave është i projektuar) ose një kënd (nëse sistemi i referimit të koordinatave nuk është i projektuar).

Një kërkesë e rëndësishme, e rrjeteve statistikore është formimi i tyre nga qeliza me sipërfaqe të barabartë, prandaj rrjetet e bazuara në sistemet koordinative referencë, të paprojektuar duhet të përdoren vetëm në hapësira të vogla për të cilat qelizat mbajnë përmasa të krahasueshme.

Përveç kësaj, nëse kërkohet një sistem referimi i rrjetit, rrjeti mund të karakterizohet nga një pikë origjine. Pika e originës është pika e poshtme në të majtë të rrjetit. Akset janë paralele me aksin e sistemit referues koordinativ, të orientuar nga e majta në të djathtë dhe nga poshtë - lartë. Dyshja (gjerësi, lartësi) përcakton madhësinë e rrjetit.

Një rrjet statistikor përbëhet nga qeliza të rrjetit statistikor. Qelizat statistikore të rrjetit karakterizohen nga atributet e mëposhtme:

Kodi i qelizës. Ky kod vepron si një identifikues. Rregullat e ndërtimit të tij janë përshkruar më poshtë.

Pozicioni gjeografik: Ky pozicioni është pozicioni i qelizës në këndin e poshtëm majtas brenda sistemit koordinativ referues të rrjetit. Pika referuese e një

qelize të rrjetit duhet të jetë këndi i poshtëm majtas i rrjetit të qelizës.

Pozicioni i rrjetit: Pozicioni i rrjetit përcaktohet nga tipi i të dhënave *Pozicioni i Rrjetit*. Është pozicioni i qelizës në sistemin e referimit të rrjetit.

Gjeometria: Kjo gjeometri është një poligon katror, që përfaqëson qelizën e rrjetit.

Ekziston një tepricë informacioni mes atributeve. Natyrisht, të gjitha këto pjesë të ndryshme të informacionit duhet të jenë të qëndrueshme dhe të paktën një nga *Kodet e Atributeve, Pozicioni Gjeografik, dhe Pozicioni i Rrjetit*.

Përfitimi i përdorimit të këtij kodi qëndron në faktin se ai mundëson rindërtimin e qelizës së trjetit lehtësisht prej tij. Përfshirja e kodit EPSG brenda kodit mundëson përzierjen e qelizave me CRS të ndryshme në një grup të dhënash.

Për një qelizë të rrjetit, kodi i vlerave të attributeve, *Pozicioni Gjeografik*, *Pozicioni i Rrjetit* dhe *Gjeometria*, duhet të jenë në përpunhje së bashku dhe gjithashtu me atributet e rrjetit.

Rrjetet hierarkike

Rrjetet me rezolucione të shumëfishta përfaqësohen nga një strukturë hierarkike përmes dy lidhjeve. Çdo Rrjet *Statistikor* mund të shoqërohet me një rrjet tjetër statistikor me rezolucion më të lartë ose më të ulët përmes lidhjes së marrëdhënieve hierarkike. *Qelizë e Rrjetit Statistikor* që i përket një Rrjeti *Statistikor* të caktuar, është e përbërë nga qeliza mbivendosëse të trjetit



me rezolucion më të ulët të tij dhe krijon qelizën që mbivendoset në rezolucionin më të lartë të rrjetit. Qelizat e rrjetit statistikor të ulët apo të lartë janë lidhur përmes përbërjes hierarkike.

Në raste të ndryshme, kur kërkohet, rrjetet sipas rezolucioneve të ndryshme përfaqësohen

nëpërmjet përbërjes hierarkike dhe shoqërimeve të marrëdhënieve hierarkike.

Shembull 1: Në rastet kur një qelizë e një rrjeti të një niveli më të lartë hierarkik, është e lidhur me katër qeliza të një rrjeti të nivelit më të ulët, kjo është një strukturë pemë të dhëash (shih figura 5).




Figura 5: Shembull i rrjetit hierarkik: Një strukturë quad tree⁴

Shembull 2: Figura 6 paraqet një shembull të një rrjeti me shumë rezolucion (nivele hierarkike). Qelizat më të mëdha (rezolucion prej 1 km) janë agregimet e qelizave më të vogla e $4 * 4$ (rezolucion 250 m).




Figura 6: Shembull i rrjetit me shumë rezolucion

⁴ Quad Tree - kuptohet një strukturë të dhëash që paraqitet si një “katror pemë”, duke kuptuar që çdo nyje e kategorit simbolizon pasardhësit që kjo pemë ka. Përdoren më shpesh për ndarjen e një hapësire dydimensionale, duke e ndarë në katër sektorë ose rajone.



Një model i përgjithshëm i mbulimit të rrjetit bazuar në SSH EN ISO 19123:2007 është specifikuar në modelin konceptual të përgjithshëm. Ky model nuk është i përshtatshëm për rrjetet statistikore, sepse kahasuar me rrjetet e tjera, rrjetet statistikore nuk përdoren si mbulime në këtë kohë. Qelizat e rrjetit përdoren nga profesionistët, si karakteristika normale për referencën gjeohapësinore. Për më tepër, modeli konceptual i përgjithshëm i rrjetit është shumëdimensional, ndërsa rrjetet statistikore janë vetëm rrjete të thjeshtë dydimensionale. Megjithatë, nëse ekziston nevoja për të përfaqësuar rrjetet statistikore si mbulime, rekandomohet të përdoret modeli konceptual i përgjithshëm për *Mbulimi i Rrjetit të Korrigjuar*. Për të përfaqësuar

mbulimet e rrjeteve statistikore, duhet të përdoret modeli konceptual i përgjithshëm për *Mbulimin e Rrjetit të Korrigjuar*.

Rrjeti Panevropian

Për aplikimet panevropiane, janë të nevojshëm të specifikohen disa rrjete të përbashkëta evropiane. Rrjetet statistikore të rekomanduara ndjekin sa më shumë të jetë e mundur rekomandimet e specifikimeve të INSPIRE për sistemet e rrjetit gjeografik.

3.1.2.3 Njësitë statistikore – Formati vektor

Kjo paketë lejon përfaqësimin e njësive statistikore të pikës, linjës ose poligonit (shih figurën 7). Këto njësi statistikore vektoriale karakterizohen nga një Inspire Id, të paktën një gjeometri, kodi i shtetit, disa emra të mundshëm gjeografik dhe kanë atributë të përkohshme.




Figura 7 – Diagrami UML për paketën vektor



Një njësi statistikore vektoriale mund të ketë disa gjeometri të specifikuara dhe me shoqërimë gjeometrike. Këto gjeometri përfaqësohen nga tipi i të dhënave *Gjeometria e Njësisë Statistikore Vektor*. Një gjeometri e njësise statistikore vektoriale karakterizohet nga:

- Nga vetë gjeometria vektoriale (atribut i gjeometrisë). Ky tip atributi është *Objekt*, siç përshkruhet në SSH EN ISO 19107:2005. Ky standard përdoret gjërësisht në GIS për të përfaqësuar gjeometritë pikë, linjë, sipërfaqe, të plotë etj.

- Një gjeometri (atributi *Gjeometria Përshkruese*). Gjeometria përshkruese ka një lloj atributi, me vlera midis kodeve *Lloji i Gjeometrisë*. Fushat me shkallë më të detajuara dhe më pak të detajuara duhet të sigurohen vetëm pér përshkrimin e gjeometrisë përshkruese me një lloj Gjeometrie të përgjithësuar (shih figurën 8).




Figura 8: Disa gjeometri të përgjithshme të njësive statistikore të zonës

Kur është e mundur, mund të publikohen disa përfaqësimë gjeometrike të njësive statistikore vektoriale.

Janë shtuar kufizimet e mëposhtme:

Çdo njësi statistikore vektoriale nuk mund të ketë më shumë se një gjeometri me një lloj gjeometrie referencë.

Gjeometria përshkruese me llojin e *Gjeometrisë së Përgjithshme* duhet të jenë shembuj të klasës së *Gjeometrisë Përshkruese së Përgjithshme*.

Njësítë statistikore vektoriale me një shembull të gjeometrisë së referencës së *Multisipërfaqe* duhet të jenë raste të klasifikimit të *Njësisë Statistikore të Zonës* të specializuar.

Për secilën njësi statistikore vektoriale, duhet të përcaktohet saktësisht një gjeometri referencë. Kjo

gjeometri referencë është gjeometria “zyrtare” e njësise statistikore.

Nuk ka asnje detyrim pér të publikuar gjeometrinë referencë: Një ofrues i të dhënave mund të publikojë vetëm një version të përgjithësuar. Në këtë rast, burimi i gjeometrisë duhet të përcaktohet në metadatë (si element i linjës).

Njësítë statistikore të llojit poligon (sipërfaqe) zakonisht organizohen në një strukturë hierarkike (shih figurën 9). Këto njësi statistikore përbëhen nga njësítë statistikore të tjera të po të njëjtë lloj, poligon. Një strukturë e tillë përfaqësohet përmes marrëdhënies hierarkike: një njësi statistikore e një zone të caktuar mund të lidhet me njësítë më të ulëta përbërëse, si dhe me njësítë më të larta që ajo formon.




Figura 9: Hierarkia e njësive statistikore të llojit poligon

Atëherë kur është e mundur, marrëdhëniet ndërmjet njësive statistikore duhet të jepen.

Shënim 1. Një njësi statistikore poligon mund të formojë disa njësi të ndryshme të një niveli më të lartë. siç tregohet në figurën 10: Marrëdhënia kardinale në këtë rast është 0 .. *.




Figura 10: Çdo njësi statistikore mund të formojë disa njësi statistikore të një niveli më të lartë



Shënim 2. Nuk ka asnje detyrim për të dhënë një gjeometri për njësitet statistikore të niveleve të mësipërme: Një njësi statistikore mund të paraqitet si një përbërje e njësive të tjera statistikore të një niveli më të ulët dhe nuk ka ndonjë detyrim që të sigurohet një gjeometri për këtë njësi të aggreguar. Sigurisht, në rast se jepet një gjeometri, kjo gjeometri duhet të jetë një agregim i njësive më të ulëta.

Në shumë grupe të dhënash të njësive statistikore, njësitet statistikore mbulojnë hapësirën gjeografike dhe përbëjnë një mozaik. Lidhje të tillë që formojnë mozaikë përfaqësohen nga rastet e klasës *Mozaiku Statistikor*. Një mozaik statistikor nuk është një njësi statistikore, por një mbledhje e njësive statistikore me kufizime topologjike (nuk lejohet mbivendosja apo boshllëjet ndërmjet njësive statistikore që formojnë një mozaik statistikor).

Mozaikët statistikorë mund të organizohen në një hierarki, siç tregohet në figurën 11. Lidhja e marrëdhënieve hierarkike lejon lidhjen e mozaikëve të sipërm dhe të poshtëm statistikorë. Marrëdhëniet hierarkike midis mozaikëve statistikorë dhe njësitet e tyre statistikore përbërëse duhet të janë të qëndrueshme.

Për njësitet statistikore poligon që formojnë një mozaik, duhet të sigurohet një objekt i qartë që përfaqëson këtë mozaik. Mund të jepen marrëdhëniet ekzistuese hierarkike mes këtyre mozaikëve.

Njësitet statistikore poligon shpesh janë ndërtuar nga njësitet administrative. Për të nxjerrë nga një njësi e dhënë statistikore njësinë administrative nga e cila është ndërtuar, ekziston një lidhje drejt klasës së njësisë administrative.




Figura 11: Lidhja ndërmjet njësive statistikore poligon dhe njësive administrative prej të cilave ajo është ndërtuar

Atributet *Fillimi i Ciklit Jetësor* dhe *Përfundimi i Ciklit Jetësor* i klasës së *Njësisë Statistikore Vektoriale* dhe lidhja e prejardhjes së klasës së *Njësive Statistikore të Zonave* përdoren për të përfaqësuar përkohshmérinë e *Njësisë Statistikore Vektoriale*. Këto komponentë përshkruhen më tej në seksionin mbi përfaqësimin e dimensionit kohor.

Menaxhimi i identifikuesit

Njësitet statistikore vektoriale, mozaikët statistikorë dhe rrjetet statistikore janë të identifikueshmë nga një identifikues Inspire. Përveç kësaj, qelizat statistikore të rrjetit identifikohen nga një kod dhe njësitet statistikore vektoriale mund të identifikohen me identifikuesit tematikë alternativë.

Përfaqësimi i kohës

Të dhënët statistikore dhe njësitet statistikore ndryshojnë me kalimin e kohës. Ndryshimi i të dhënave statistikore është jashtë qëllimit të këtij dokumenti. Të dhënët statistikore të bashkangjitura në një njësi statistikore duhet të kenë përfaqësimin e tyre kohor, duke përdorur, për shembull, një Faqe | 16814

periudhë kohore që përfaqëson periudhën në të cilën këto të dhëna janë konsideruar reale. Kështu që, vetëm ndryshimet e njësisë statistikore janë marrë në konsideratë në këtë dokument.

Qelizat statistikore të rrjetit dhe rrjetet statistikore nuk ndryshojnë me kalimin e kohës (kjo është një nga përparësítë e përdorimit të tyre). Asnjë përfaqësim kohor nuk kërkohet për to.

Për njësitet statistikore vektoriale, një metodë tradicionale për të paraqitur ndryshimet është që të pranojë një model “të castit”. Ndryshimet nuk menaxhohen në nivelin e objektit, por në nivelin e të dhënave. Këtu propozohet që evolucioni të përfaqësohet në mënyrë të qartë në nivel objekti. Më poshtë janë paraqitur evolucionet e ndryshme:

- krijimi (shiko fig. 12a);
- fshirje/zhdukje (shiko fig. 12b);
- ndryshimi (shiko fig. 12c) (këtu merren në konsideratë si ndryshimet gjeometrike ashtu edhe ato të attributeve).



Këto ndryshime përfaqësohen përmes attributeve Periudha e Vlefshmërisë, *Fillimi i Ciklit Jetësor* dhe *Përfundimi i Ciklit Jetësor*.

Krijimi, ndryshimet dhe fshirja/zhudukja duhet të përfaqësohen, duke përdorur atributet *Periudha e Vlefshmërisë*, *Fillimi i Ciklit Jetësor* dhe *Përfundimi i Ciklit Jetësor*.




Figura 12. Rastet tipike të ndryshimeve të njësive statistikore

Për njësitë statistikore poligon, mund të paraqiten dy zhvillime shtesë:

- agregimi (bashkimi) (shih figurën 12d.), kur disa njësi statistikore bashkohen për të formuar një njësi tjeter;

- ndarja (shih figurën 12e.), kur një njësi statistikore ndahet në një pjesë ose disa të tilla.

Objektet e aggreguara dhe të ndara janë të lidhura përmes marrëdhënies origjinë.

Prejardhja e njësive statistikore të aggreguara dhe të ndara duhet të përfaqësohet duke përdorur një lidhje me origjinën, me rolet e pasardhësve dhe paraardhësve.

Përfaqësimi i evolucioneve

